

## PROCEVERBAL

- I mbajtur sot më datë 28.05.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Zv/Kryetare e Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 16 vota pro.
- Miratohet procesverbal i mbledhjes së datës 30.04.2025 me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota pro.
- Miratohet fillimi I mbledhjes me ketë rend dite si më poshtë vijon:
  1. Miratimi i rendit të ditës.
  2. Miratimi I procesverbalit të mbledhjes së datës 30.04.2025.
  3. P/Vendim “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha prill 2025”.
  4. **P/Vendim** “Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën janar-prill 2025”
  5. **P/Vendim** “Përdorim fondi rezerve për “Bashkëfinancim Ndërtim infrastrukture për të rinjt e Librazhdit”.
  6. **P/Vendim** “Përdorim fondi rezerve për “Bashkëfinancim rikostruksion tërësor dhe rindërtim I palestrës së shkollës Vilson Blloshmi”.
  7. **P/Vendim** “Përdorim fondi rezerve për financimin e “Akt-marrëveshjes “Monitorimin e një ure tip Bailley në fshatin Polis Sheh Njësia Administrative Polis”.
  8. **P/Vendim** “ Për dhënie ndihme financiare”
  9. **P/Vendim** “ Për miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dhënien e ndihmës financiare për familjen e Z.Jeshar Boci, banor i fshatit Zgosht Nj/A Lunik Bashkia Librazhd, banesa e të cilit ka pësuar fatkeqësi natyrore ( rrëshqitje trualli).
  10. **P/Vendim** “ Për miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dhënien e ndihmës financiare për familjen e Z.Zenun Balla, banor i lagjes Nr 1 qytet, Bashkia Librazhd, banesa e të cilit ka pësuar fatkeqësi natyrore(Rënje zjarri dt.16.02.2025).
  11. **P/vendim** “ Për miratimin e hapjes së rrugëve auto”
  12. **Të ndryshme:**
    - 1.P/**Vendim** “Për miratimin e përfundimet të procesit të privatizimit të banesës(nënshkrimin e kontratës së privatizimit) për shtetasin Z.Shekfi Mojsja.
    - 2.P/**Vendim** “Për miratimin e procesit të privatizimit për truallin nën objekt të znj.Fiqirete Hoxha,ne zbatim te vkm-se nr.329,date 22.05.2019”.
    - 3.P/**Vendim** “Për dhënie ndihme financiare”
    - 4.P/**Vendim** “Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga program I subvencionimit të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti”.
    - 5.P/**Vendim** “Propozim për dhënie në përdorim të hapsirës publike”.

### **Fillimi i mbledhjes:**

**P/Vendimi nr 1** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha prill 2025”.

Fjalën e merr këshilltarja Fatbardha Qatja.

Në fakt doja të flisja pa miratuar rendin e ditës,këto p/vendimet tek të ndryshmet që mos na ngarkoni kaq shumë. Në lidhje me p/vendimin e 6% të ndihmës ekonomike e kam me specialisten e zyrës,I trajtoni rastet të gjitha njësoj pasi nje familje ja hiqni dhe një e lini kur kanë të njënjtin problem.

Fjalën e merr këshillitari Ndriçim Doda.

Kam një sygjerim për zyrë e ndihmës ekonomike,ku duhet të dilni më shume në terren se besoj ka plot familje që na thonë: Që pse ne nuk përfitojmë ndihmë ekonomike?Ku duhet të aplikojmë për të përfituar ndihmën ekonomike?Në qoftë se janë mundësítë dhe keni fonde,ndihmoni sa më shumë familje.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

**P/Vendim nr 2** “Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën janar-prill 2025”

Fjalën e merr këshilltarja Fatbardha Qatja.

Vazhdon e njënja gjë ne lidhje me raportin e monitorimit,ku relacionin na e sillni shum të vakët,na e sillni me të gjitha detajet që dhe ne mos kemi kundërshtime.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Po të shikoni këto investime shikojmë që vlera nuk është e saktë ose ti shikojnë specalisitet e zyrës mos ka dhe nje lapsus pasi mua nuk me duken te sakta.

Pastaj shikoj dhe investimin,rruga për te kasha e keni përmendur dy here,keni bërë një parapafim për zjarrfiksen,kur ky mjet akoma nuk ka ardhur.

Fjalën e merr Emanuela Çekrezi për të sqaruar pyetjet e bëra nga këshilltari:

Në lidhje me investimin rruga për te kisha e kemi përmendur dy here sepse njëher është mbikqyrje dhe njëher është kualidim.Kurse në lidhje me parapagimin që kemi bërë në lidhje me zjarrfiksen ne e kemi pas të shkruar në kontratë që një pjesë të shumës duhet ta paguaj para se mjeti të vi në Shqipëri.

Në lidhje me pyetjen e bërë nga këshilltarja Fatbardha Qatja që pse nuk e keni me detaje relacionin, ne jemi munduar ta sjellim të përmbledhur pasi ka një format shumë të madh.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 15 vota pro dhe 1 apstenim.

**P/Vendim nr 3** “Përdorim fondi rezerve për “Bashkëfinancim Ndërtim infrastrukturre për të rinjt e Librazhdit”.

Fjalën e merr këshilltarja Fatbardha Qatja.

Pse nuk e parshikonit në buxhet këtë investim me vlerë kaq të madhe por prekni fondin rezervë ku jemi akoma në gjysëm të vitit dhe mos kemi ndonje rast emergjent dhe sdo kemi fonde?

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Kur kan qënë këto projektet për 100 fshatrat pse nuk u bë anjë investim?

Kryetari I Bashkisë Mariglen Disha e merr fjalën për të sqaruar:

Në lidhje me projketin e 100 fshatrave nuk u bë asnjë lloj investimi për arsy se keto fonde I shkuan në ndihmë familjeve që u prekën nga termeti.

Sekretari I Pergjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën:

Në lidhje me pyetjen e këshilltares Fatbardha Qatja, dëshira e mire e Kryetarit të Bashkisë për të bërë sa më shumë investime për qytetin dhe kur është për të mirën e komunitetit dhe fondin rezervë do prekim. Ky projekt në zonën e Fushë Studës do jetë një investim shum I mire ku do ndikoj shumë tek turistët e huaj por dhe te ata vendas.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro**.

**P/Vendim nr 4** “Përdorim fondi rezerve për “Bashkëfinancim rikostruksion tërësor dhe rindërtim I palestrës së shkollës Vilson Blloshmi”.

Këshilltarët nuk kanë asnjë pyetje në lidhje me këtë p/vendim dhe falenderojnë Kryetarin e Bashkisë që e bëri të mundur financimin e rikostruksionit tërësor të shkollës “Vilson Blloshmi” dhe rindërtimin e palestrës së shkollës.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro**.

**P/Vendim nr 5** “Përdorim fondi rezerve për financimin e “Akt-marrëveshjes “Monitorimin e një ure tip Bailley në fshatin Polis Sheh Njësia Administrative Polis”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro**.

**P/Vendim nr 6 “ Për dhënie ndihme financiare”**

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

**P/Vendimi nr 7** Për miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dhënien e ndihmës financiare për familjen e Z.Jeshar Boci, banor i fshatit Zgosht Nj/A Lunik Bashkia Librazhd, banesa e të cilit ka pësuar fatkeqësi natyrore ( rrëshqitje trualli).

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

**P/Vendimi nr 8** “Për miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dhënien e ndihmës financiare për familjen e Z.Zenun Balla, banor i lagjes Nr 1 qytet, Bashkia Librazhd, banesa e të cilit ka pësuar fatkeqësi natyrore(Rënie zjarri dt.16.02.2025).

Fjalën e merr këshilltarja Fatbardha Qatja.

Atë ditë kam parë një tmerr pasi u shkërmoq cdo gjë nga flakët,a është mundësia ta ndihmojmë dhe pak më shumë se çështë parashikuar në këtë P/vendim pasi dëmi është shumë I madh?

Kryetari I Bashkisë Mariglen Disha e merr fjalën për të sqaruar:

Dëshira është shumë e madhe që ta ndihmojmë këtë familje,por ligji nuk na lejon,Sektori I Emergjencave Civile mbas verifikimit në terren ka bërë maksimumin dhe e mundshëm dhe nuk mund të shkojmë më shumë se kjo vlerë që I kemi dhënë.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

**P/Vendimi nr 9“ Për miratimin e hapjes së rrugëve auto”**

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Shikoj këtë relacionin për hapjen e këtyre rrugve që nuk është e cilsuar që si është ky truall tokë shtet se mos na del me pronar dhe krijojmë sherre të kota.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më 12 vota pro 2 kundër dhe 1 apstenim.

**P/Vendimi nr 10 “Për miratimin e përfundimet të procesit të privatizimit të banesës(nënshkrimin e kontratës së privatizimit) për shtetasin Z.Shekfi Mojsja.**

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

**P/Vendimi nr 11** “Për miratimin e procesit të privatizimit për truallin nën objekt të znj.Fiqirete Hoxha,ne zbatim te vkm-se nr.329,date 22.05.2019”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro**.

**P/Vendimi nr 12**“Për dhënie ndihme financiare”

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro**.

**P/Vendimi nr 13** “Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga program I subvencionimit të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Bashkia Librazhd cfarë roli ka në lidhje me kredit e buta? Pse nuk I përbaheni një manuali që kush përfiton dhe kush jo? A nuk duhet të ketë një marrveshje Bashkia me bankat për të ndihmuar këto familje?

Sekretari I Pergjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën:

Roli I Bashkisë është të mbledhi dokumentacionin e nevojshëm dhe I përbahemi kritereve qe kush përfiton nga program I subvencionimit të interesave të kredisë së butë me kushte lehtësuese nga shteti.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro**.

**P/Vendimi nr 14** “Propozim për dhënie në përdorim të hapsirës publike”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Mos e prek rruga këtë hapsirë publike dhe a është bërë verifikimi I duhur në lidhje me këtë tokë që po jepet në përdorim?

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 12 vota pro dhe 2 kundër.

SEKRETARI KËSHILLIT  
**Elson MALLUTA**

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT  
**Silvana HOXHA**

